

VENDIM
Nr. 69, datë 2.2.2022

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES PËR NDËRLIDHJEN E SKEMAVE PËR
IDENTIFIKIMIN ELEKTRONIK TË SHTETASVE TË BALLKANIT
PERËNDIMOR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Brendshëm dhe të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes për ndërlidhjen e skemave, për identifikimin elektronik të shtetasve të Ballkanit Perëndimor, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj

MARRËVESHJE
**PËR NDËRLIDHJEN E SKEMAVE, PËR IDENTIFIKIMIN ELEKTRONIK TË
SHTETASVE TË BALLKANIT PERËNDIMOR**

Ne, pjesëmarrësit e Ballkanit Perëndimor, të referuar bashkërisht si “Palët Kontraktuese” dhe individualisht si “Pala Kontraktuese”;

të bindur për domosdoshmërinë e bashkëpunimit të ndërsjellë në fushën e digjitalizimit të administratës publike dhe sigurimit të ofrimit të shërbimeve të qeverisjes elektronike, *e-Qeverisje*, dakordësuar nga të gjitha Palët Kontraktuese në memorandumet përkatëse të Ballkanit Perëndimor, me qëllim përmirësimin e efikasitetit të administratës publike në interes të shtetasve të Palëve Kontraktuese;

duke respektuar marrëveshjet ndërkombëtare të nënshkruara, veçanërisht në fushën e ofrimit të shërbimeve të besuara dhe identifikimit elektronik;

duke pasur parasysh objektivat e nismës për Ballkanin e Hapur;

duke pasur parasysh Deklaratën e Përbashkët të nënshkruar në Novi Sad, më 10 tetor 2019, e cila bazohet në objektivin e zbatimit të katër lirive kryesore të tregut të përbashkët të BE-së në Ballkanin Perëndimor;

duke njohur Deklaratën e Përbashkët të Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë, Kryeministrit të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Presidentit të Republikës së Serbisë, të miratuar në Samitin e Ballkanit Perëndimor, të mbajtur në Ohër, më 10 nëntor 2019;

duke pranuar Deklaratën e Përbashkët të Kryeministrit të Shqipërisë, Kryeministrit të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Presidentit të Republikës së Serbisë, të miratuar në Samitin e Ballkanit Perëndimor, në Tiranë, më 21 dhjetor 2019;

duke theksuar qëllimin, interesin dhe bazat e përbashkëta për rritjen e bashkëpunimit dhe partneritetit;

duke ftuar pjesëmarrësit e tjerë të Ballkanit Perëndimor që t'i bashkohen kësaj Marrëveshjeje në frymën e gjithëpërfshirjes, bashkëpunimit rajonal dhe me synimin për të përmirësuar jetën e të gjithëve brenda rajonit,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje është që Palët Kontraktuese të ofrojnë akses në shërbimet e tyre të *e-Queverisjes*, për shtetasit e Palëve të tjera Kontraktuese, duke përdorur skemat e verifikimit për identifikimin elektronik të Palës Kontraktuese, së cilës i përket shtetasi që përdor shërbimet e qeverisjes elektronike, *e-Queverisje*.

Neni 2 PËRKUFIZIME

Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, termit e mëposhtëm do të kenë kuptimin:

1. Shtetas - personi që ka shtetësinë e njëres prej Palëve Kontraktuese;
2. Numri i identifikimit për Ballkanin e Hapur - tregon referencën, d.m.th. numrin unik të identifikimit, të lëshuar shtetasit nga Pala Kontraktuese, të shtetësisë së tij/saj, në përputhje me këtë Marrëveshje, me qëllim të përdorimit të shërbimeve elektronike në kuadër të iniciativës së Ballkanit të Hapur;
3. Federimi i identiteteve elektronike - vendosja e një marrëdhënie besimi ndërmjet Palëve Kontraktuese, duke siguruar transmetim të sigurt të identifikimit, autentikimit dhe informacionit për identifikimin elektronik të përdoruesve që janë shtetas të njëres prej Palëve Kontraktuese, dhe që kërkojnë shërbimet elektronike të një Pale tjetër Kontraktuese; në përputhje me standardet përkatëse për federimin e identiteteve elektronike;
4. Ndërlidhja e skemave nënkupton përcaktimin e nivelit minimal të ndërveprimit të skemave *e-ID*, për autentikim elektronik ndërkufitar të shtetasve të tyre në funksion të përcaktimit të sasisë së të dhënave të shkëmbyera, formateve d.m.th., duke aktivizuar federimin e identiteteve elektronike.

Neni 3 OBJEKTI I MARRËVESHJES

Palët Kontraktuese do të bashkëpunojnë për arritjen e qëllimit të përcaktuar në nenin 1 të kësaj Marrëveshjeje, dhe në veçanti ato do të:

- njohin skemat e regjistruara të identifikimit elektronik në Palët Kontraktuese të ofruara nga lëshuesit e skemave të identifikimit elektronik;
- bashkojnë/kombinojnë zgjidhjet e softeve kombëtare, që do të mundësonin federimin e identiteteve elektronike në parimin e ndërlidhjes së skemave me shërbimet e qeverisjes elektronike të Palëve të tjera Kontraktuese;
- vendosin dhe zbatojnë numrin e ID-së së Ballkanit të Hapur për shtetasit e tyre - të lëshuar nga secila Palë Kontraktuese;
- nxisin përdorimin e shërbimeve elektronike, të cilat do të konfirmonin, avanconin dhe forconin më tej objektivat në kuadër të iniciativave të bashkëpunimit ndërmjet Palëve Kontraktuese.

Skemat e përmendura në këtë Marrëveshje, të ofruara nga lëshuesit e skemave të përmendura këtu dhe të regjistruara në regjistrat përkatës, do të njihen në mënyrë të ndërsjellë, regjistrat e duhur janë si më poshtë:

1. Regjistri i ofruesve të shërbimeve të identifikimit elektronik dhe skemave të identifikimit elektronik në Republikën e Serbisë;
2. Regjistri i ofruesve të shërbimeve të besuara dhe skemave të identifikimit elektronik në Republikën e Maqedonisë së Veriut;
3. Regjistri i ofruesve të shërbimeve të besuara dhe i skemave të identifikimit elektronik në Republikën e Shqipërisë.

Shkëmbimi i të dhënave të nevojshme për zbatimin praktik të skemave të identifikimit elektronik të njohur reciprokisht dhe të përcaktuara në këtë nen, kryhet në përputhje me standardet e ndërveprimit për shkëmbimin e të dhënave.

Neni 4

NUMRI I ID-së I BALLKANIT TË HAPUR

Shtetasit mund të marrin numrin e ID-së së Ballkanit të Hapur në portalin e tyre të qeverisjes elektronike ose në portalin e tyre kombëtar për identifikim elektronik.

Një parakusht për marrjen e numrit të ID-së së Ballkanit të Hapur është që një shtetas të ketë një identitet elektronik të lëshuar sipas skemës së regjistruar të identifikimit elektronik në vendin e tij/saj.

Numri i ID-së i Ballkanit të Hapur përfaqëson një atribut shtesë të identitetit ekzistues elektronik të një shtetasi, që i jep atij/saj mundësinë për të ushtruar të drejta brenda fushës së nismës së Ballkanit të Hapur, në përputhje me marrëveshjet përkatëse dhe dokumentet e tjera që janë në fuqi ndërmjet Palëve Kontraktuese, si dhe në përputhje me aktet normative dhe praktikën e secilës prej Palëve Kontraktuese.

Neni 5

KOORDINIMI DHE KOMUNIKIMI

Palët Kontraktuese duhet të krijojnë dhe mbajnë koordinimin dhe komunikimin ndërmjet autoriteteve kompetente për zbatimin teknik dhe ligjor të kësaj Marrëveshjeje.

Palët Kontraktuese duhet të njoftojnë njëra-tjetrën, nëpërmjet kanaleve të duhura të autoriteteve kompetente, të referuara në paragrafin e parë të këtij neni, dhe duhet të shkëmbejnë informacion për pikat e kontaktit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga data e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje.

Përfaqësuesit e autoriteteve të referuara në paragrafin e parë të këtij neni duhet të zhvillojnë takime të rregullta, të paktën një herë në një periudhë 3 (tre)-muajore dhe duhet t'u raportojnë Palëve Kontraktuese rezultatet e këtyre takimeve. Takimi i parë do të mbahet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje.

Përveç komunikimit gjatë takimeve, referuar paragrafit të 3-të të këtij neni, shkëmbimi i informacionit përkatës për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje duhet të jetë në formë të shkruar, elektronike ose në letër.

Palët Kontraktuese duhet të njoftojnë njëra-tjetrën me shkrim për çdo ndryshim, lidhur me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga data e ndodhjes së këtyre ndryshimeve.

Neni 6

SHKËMBIMI DHE MBROJTJA E TË DHËNAVE KONFIDENCIALE

Palët kontraktuese bien dakord që informacioni i klasifikuar, siç përcaktohet nga legjislacioni i secilës Palë Kontraktuese, nëse shkëmbehet në kuadrin e bashkëpunimit të parashikuar nga kjo Marrëveshje, do të mbahet si informacion i klasifikuar i huaj dhe se ky informacion do të ruajë nivelet e klasifikimit që i janë caktuar në Palën tjetër Kontraktuese.

Tabela e duhur e ekuivalencës së niveleve të klasifikimit, e parashikuar nga legjislacioni i brendshëm i Palëve Kontraktuese, duhet të dakordësohet dhe shkëmbehet, jo më vonë se 90 (nëntëdhjetë) ditë nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 7

MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE

Përpunimi i të dhënave personale ndërmjet autoriteteve kompetente të Palëve Kontraktuese, duhet të kryhet në përputhje me legjislacionin përkatës kombëtar dhe marrëveshjet ndërkombëtare, dhe duke zbatuar parimet e parashikuara në Rregulloren e BE-së 2016/679, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit.

Neni 8
DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE DHE KALIMTARE

Përshkrimi teknik i numrit të ID-së për Ballkanin e Hapur dhe proceset e tij, do të përcaktohen në Protokollin shtesë të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 9

Çdo mosmarrëveshje që lind nga interpretimi ose zbatimi i kësaj Marrëveshjeje duhet të zgjidhet nëpërmjet negociatave.

Neni 10

Kjo marrëveshje nuk do të prekë të drejtat dhe detyrimet e Palëve Kontraktuese që rrjedhin nga traktatet e tjera ndërkombëtare në të cilat ato janë palë.

Neni 11

Kjo Marrëveshje është subjekt ratifikimi ose miratimi, në përputhje me procedurat e brendshme të secilës Palë Kontraktuese. Republika e Shqipërisë do të veprojë si Depozitar i kësaj Marrëveshjeje.

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në ditën e 30 (tridhjetë), nga data e depozitimit të instrumenteve të ratifikimit nga të paktën dy Palë Kontraktuese dhe do të prodhojë efekte ligjore vetëm ndërmjet Palëve Kontraktuese.

Për një Palë Kontraktuese, e cila ratifikon ose miraton këtë Marrëveshje pas hyrjes në fuqi në përputhje me paragrafin e dytë të këtij neni, kjo Marrëveshje hyn në fuqi në ditën e 30 (tridhjetë), nga data e depozitimit të instrumentit të ratifikimit nga kjo Palë Kontraktuese.

Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet me miratimin e ndërsjellë të Palëve Kontraktuese.

Kjo Marrëveshje mbetet në fuqi në mënyrë të pakufizuar.

Në rast se kësaj Marrëveshjeje i kalon afati, duhet të vijojë mbrojtja e informacionit konfidencial, në përputhje me nenin 6 të saj.

Çdo Palë Kontraktuese, mund të tërhiqet nga kjo Marrëveshje duke njoftuar Depozitarin, në formë të shkruar, për qëllimin e tërheqjes. Në rast të tillë, Marrëveshja do të pushojë së qeni në fuqi për atë Palë Kontraktuese, në ditën e 30 (tridhjetë) nga data e marrjes së njoftimit nga Depozitari.

Origjinali i kësaj Marrëveshjeje në një kopje të vetme në gjuhën angleze, duhet të depozitohet te Depozitari, i cili do të dërgojë një kopje të certifikuar te çdo Palë Kontraktuese.

Bërë në Tiranë, më datë njëzet e një dhjetor dy mijë e njëzetë e një.

Aleksandar Vučić
President i Republikës së Serbisë

Edi Rama
Kryeministër i qeverisë së Republikës së
Shqipërisë

Zoran Zaev
President i qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut